

RAPORT BASHKIMI

Ne Tirane, sot me date 12.12.2014, ne seline e shoqerise "KLAR" shpk, u mbledhen palet e meposhtme;

PALET:

1- SHOQERIA « KLAR» SHPK, e pajisur me NIPT K81309049N, me seli ne Rr "Duresit-ish Uzina Tirana", me ortak te vetem Shkelqim Beshiri dhe perfaqesuar ne kete akt marrveshje nga Administratori Gentjan Sali, i biri i Bujarit, i dtl 15.10.1979, lindur ne Sarande dhe banues ne Tirane, i pajisur me karte identiteti Nr 024453241, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

2- SHOQERIA "LADJUS" shpk, e pajisur me NIPT L12227010D, me seli ne Rr "Loçka", prane Komunes Kashar, Yrshek, me ortak te vetem Shkelqim Beshiri dhe perfaqesuar ne kete akt marrveshje nga Administratori Gentjan Sali, i biri i Bujarit, i dtl 15.10.1979, lindur ne Sarande dhe banues ne Tirane, i pajisur me karte identiteti Nr 024453241, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BAZA LIGJORE: Neni 216 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare", I ndryshuar; Ligji Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" I ndryshuar; Vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise "Klar" shpk , date 11.12.2014 "Per inicim procedure bashkim me perthithje": Vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise "Ladjus" shpk date 11.12.2014 "Per inicim procedure bashkim me perthithje";

Te cilet rane dakord ne perpilimin e ketij raport bashkimi, si ne vijim:

1. **Objekti:** Dy Shoqerite e sipercituara kane rane dakord se do te inicojne proceduren e bashkimit me perthithje ndermjet dy shoqerive respektive: "Ladjus" shpk dhe "Klar" shpk, sipas te ciles "Ladjus" shpk do te jete shoqeria e perthithur, ndersa "Klar" shpk do te jete shoqeria perthithese. Ky vendim eshte marre me date 11.12.2014 nga dy subjekte pjesmarrese te ketij raport bashkimi.

2. **Hyrja ne fuqi e akt - marreveshjes:** Palet kane nenshkruar projekt marreveshjen per bashkim me perthithje me date 12.12.2014, e cila eshte e detyrueshme per regjistrim ne QKR.

Ne perputhje me dokumentacionet dhe afatet qe nje legjislacionin ne fuqi, palet kane rane dakord se Asambleja e Ortakut ,do te mbledhet me date 17.01.2015 per nenshkrimin e akt - marreveshjes se bashkimit me perthithje, pasi plotesohet afati 30 ditor qe nje ligji per shoqerite tregtare (Neni 216/3 dhe Neni 218)dhe Ligji per procedurat tatimore ne republiken e shqiperise.




3. **Palet ne procedure:** Shoqëria "Ladjus" shpk, e pajisur me NIPT L12227010D dhe seli ne Rr "Loçka", prane Komunes Kashar, Yrshek se bashku me Shoqërine "Klar" shpk, e pajisur me NIPT K81309049N, me seli ne Rr "Duresit-ish Uzina Tirana" kane rene dakord qe Shoqëria "Ladjus" shpk do te jete pjese e shoqërise "Klar" shpk, duke u perthithur nga "Klar" shpk me ane te procedures se bashkimit me perthithje.

4. **Zoterimi i kuotave ne secilen prej shoqërive pjesmarrese:** Shoqëria "Klar" shpk zoteron 100 % te kuotave te shoqërise "Ladjus" shpk. Shkelqim Beshiri zoteron 100 % te kuotave te shoqërise "Klar" shpk.

5. **E drejta e fitimit te ortakut:** Ortakut te vetem te shoqërise "Ladjus" shpk, i cili eshte subjekti "Klar" shpk, i lind e drejta e perfitimit te fitimit qe nga dita e miratimit te akt marrveshjes, ndermjet dy shoqërive dhe kontabilizimit te veprimeve financiare ne shoqërine perthithese.

Meqenese shoqëria e perthithur zoterohet 100% nga shoqëria perthithese "Klar" shpk, atehere nuk rezulton ndonje problem i mundshem ligjor lidhur me te drejtat e zoteruesit te kuotave, si rrjedhoje e faktit te pronesise 100% nga "Klar" shpk

6- **Kompetencat e Administratorit:** Per faktin se, Shoqëria e perthithur "Ladjus" shpk ka te njejtin administrator si shoqëria perthithese- "Klar" shpk. Administratori do te kete te gjitha te drejtat qe Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per shoqërite tregtare" I Ndryshuar i njej, me perjashtim te kompetences se perfaqesimit dhe kryerjes se veprimeve te ndryshme financiare prane te gjitha bankave te nivelit te dyte, kompetence te cilen do ta kete ortakut i vetem i shoqërise "Klar" shpk, z. Shkelqim Beshiri.

7- Masat qe do te merren per punonjesit:

-Shoqëria e perthithur "Ladjus" shpk ka 2 punonjes te renditur me funksione si me poshte vijon:

Gentjan Sali , administrator i "Ladjus" shpk, qe ka zevendesuar Z.Shefqet Haka ,

Jollanda Feshti me detyre Drejtues Teknik i shoqërise , do te jete punonjes i ketij subjekti me te njejten detyre dhe me te njejten page.

- Shoqëria "Klar" shpk ka 19 punonjes, konfirmuar ky fakt me formularin E- Sig 025 /a muaji Nentor 2014,dhe E sig 027 / I muajit Dhjetor 2014 ,te cilet do te kene te njejtin pozicion pune.

Si konkluzion, nuk do te kete masa per nderprerje te marredhenieve te punes me punonjesit aktuale.

8: Dokumentacione procedure: Palet bien dakord se do te pergatisin listen e dokumentacionit te domosdoshem, e cila do te jete pjese integrale e kesaj faze, si ne vijim:

- Vendimi I asamblese se ortakut te vetem te "Ladjus" shpk per inicim procedure bashkim me perthithje.
- Vendimi I asamblese se ortakut te vetem te "Klar" shpk per inicim procedure bashkim me perthithje
- Raport i bashkimit te dy shoqërive.
- Pasqyrat financiare te vitit ushtrimor 2011, 2012, 2013 te shoqërise "Ladjus" shpk, konfirmuar nga

DRT, Tr.



➤ Pasqyrat financiare te vitit ushtrimor 2011, 2012, 2013 te shoqerise "Klar" shpk, , konfirmuar nga DRT, Tr.

➤ Raporti ecurise se veprimtarise "Klar" shpk deri me date 31.12.2013.

9: Hyrja ne fuqi e raport bashkimit: Raport bashkimi do te jete i detyrueshem per palet dhe pjese integrale e dokumentacionit te domosdoshem per proceduren e bashkimit me perthithje, e detyrueshme per t'u regjistruar ne QKR.

PALET:

"LADJUS" SHPK
ADMINISTRATOR
GENTJAN SALI
GENTJAN SALI



"KLAR" SHPK
ADMINISTRATOR
GENTJAN SALI
GENTJAN SALI

